



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës Publikon Raportin *Buxhetimi për mirëqenien sociale*

1 korrik 2014, 9:45-12:00
Hotel Sirius, Prishtinë, Kosovë

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), nesër do të prezantojë të gjeturat kryesore dhe rekomandimet nga raporti i tyre më i ri: Buxhetimi për mirëqenien sociale: Analizë e shpejtë gjinore për të njoftuar buxhetimin e përgjithshëm gjinor për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – raporti i parë i këtij lloji në Kosovë.

Raporti përfshinë një analizë të përfituesve të të gjitha departamenteve, divizioneve dhe njësite të tjera brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Më pas raporti ekzaminon shumat e buxhetit të alokuar për gratë dhe burrat përfitues, duke identifikuar fushat potenciale të pabarazisë. Të gjeturat japin inpute specifike për buxhetin e MPMS-së për vitet 2015-2017.

Në këtë raport, RrGGK zbulon disa të gjetura befasuese:

- Linja buxhetore e asistencës sociale është pa nevojë e kufizuar. Asistenca sociale sipas indeksit të shportës minimale të ushqimit për një familje mesatare të përbërë prej katër anëtarëve, dallimi financiarë në buxhet është rreth €24,000,000.
- Në vitin 2013, pagat e burrave punonjës në MPMS përbënin 56% të buxhetit, ndërsa pagat e grave 44% të buxhetit. Burrat kanë tendencë të mbajnë pozita më të larta se gratë brenda Ministrisë, gjë që mund të ndikojë në kualitetin e shërbimeve të ofruara për gratë dhe burrat.
- Edhe pse gratë dhe burrat regjistrohen si punëkërkuar pothuajse në shifra ekuivalente, më shumë burra (64%) siguruan vende pune, se sa gra (34%).
- Burrat përfituan 89% të pensionit bazë kontribut-pagues, ndërsa gratë përfituan 11% në vitin 2013.
- MPMS nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për ofrimin e shumicës së shërbimeve sociale në përputhje me kornizën ligjor.

Nicole Farnsworth, Udhëheqëse për Hulumtime, RrGGK dhe Ada Shima, Hulumtuuese do të prezantojnë të gjetura dhe rekomandime të tjera, gjatë publikimit nesër.

Raporti u përpilua në kontekstin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës, e cila konsideron mirëqenien sociale si prioritet. Me të synohet që të sigurohen dëshmi që do të ushqenin me informata planifikimin buxhetor qeveritar, duke përfshirë edhe perspektivën gjinore. Për më tepër, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është dëshmuar të rritë transparencën dhe efikasitetin e shpenzimeve publike.

Përderisa ky raport fokusohet në MPMS, RrGGK bën me dije që ai mund të shërbejë si një udhëzues për ministrinë dhe komunat tjera lidhur me atë se si të bëhet konkretisht buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, siç inkurajohet në Qarkoren Buxhetore egzistuese.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH ka financuar raportin dhe RrGGK ka bashkëpunuar për së afërmi me MPMS. Raporti do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të RrGGK-së: www.womensnetwork.org dhe në faqen e Facebook-ut në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me 1 korrik.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org